VENDIM Nr. 414,
datë 27.6.2012

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1 114, DATË 30.7.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR DISA ÇËSHTJE NË ZBATIM TË LIGJEVE NR. 7703, DATË 11.5.1993 "PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR, NR.9136, DATË 11.9.2003 "PËR MBLEDHJEN E KONTRIBUTEVE TË DETYRUESHME TË SIGURIMEVE SHOQËRORE, DHE SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR, DHE NR.7870, DATË 13.10.1994 "PËR SIGURIMET SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 7870, datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 4 të ligjit nr. 10487, datë 5.12.2011 "Për buxhetin e vitit 2012", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.1 114, datë 30.7.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Paragrafi i parë i pikës 2 të kreut II, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Paga minimale mujore, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve, shoqërore e shëndetësore, nga data 1.7.2012 e në vazhdim, të jetë jo më pak se 18 295 (tetëmbëdhjetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë, ndërsa paga maksimale mujore të jetë 91 475 (nëntëdhjetë e një mijë e katërqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë.

2. Pikat 1, 2, 6, 7, 9, 10, 11 e 13 të kreut III, ndryshohen, si më poshtë vijon: "1.Shuma minimale mujore e kontributeve për të gjitha degët e sigurimit, për periudhën nga data 1.7.2012 e në vazhdim, të jetë 5 104 (pesë mijë e njëqind e katër) lekë.

Kontributi minimal sipas degëve të sigurimit të jetë:	në %	në lekë
Dega e sigurimit të sëmundjeve	0.3	55;
Dega e sigurimit të barrëlindjeve	1.4	256;
Dega e sigurimit të pensioneve	21.6	3 952;
Dega e sigurimit të aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale	0.3	55;
Dega e sigurimit të papunësisë	0.9	165;
Sigurimet shëndetësore	3.4	622.

2. Shuma mininale mujore e kontributit të sigurimit shëndetësor për të vetëpunësuarin dhe për pjesëtarët e papaguar të familjes, që jetojnë e punojnë me të vetëpunësuarin, të jetë 7 për qind e pagës minimale mujore, e barabartë me 1 280 (një mijë e dyqind e tetëdhjetë) lekë.

…

6. I vetëpunësuari, i vetëpunësuari në ortakëri, i vetëpunësuari që punëson të tretë (me përjashtim të të vetëpunësuarit në bujqësi), duke filluar nga data 1.7.2012 e në vazhdim, paguan për vete një kontribut të detyrueshëm për sigurimet, shoqërore dhe shëndetësore, në masën 30 për qind (23 për qind, sigurim shoqëror dhe 7 për qind sigurim shëndetësor) të pagës mujore minimale prej 18 295 (tetëmbëdhjetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e pesë) lekësh, të barabartë me 5 488 (pesë mijë e katërqind e tetëdhjetë e tetë) lekë në muaj.

7. I vetëpunëuari, për pjesëtarët e familjes së tij mbi 16 vjeç, që nuk trajtohen me pagë,

por që punojnë e bashkëjetojnë me të ligjërisht (me përjashtim të të vetëpunësuarit në bujqësi), duke filluar nga data 1.7.2012 e në vazhdim, paguan kontribut të detyrueshëm për sigurimet, shoqërore dhe shëndetësore, në masën 30 për qind (23 për qind sigurim shoqëror dhe 7 për qind sigurim shëndetësor) të pagës mujore minimale prej 18 295 (tetëmbëdhjetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e pesë) lekësh, të barabartë me 5 488 (pesë mijë e katërqind e tetëdhjetë e tetë) lekë në muaj.

…

9. Personat e vetëpunësuar në veprimtari, tregtare apo shërbimi, ambulante, nga data 1.7.2012 e në vazhdim, të deklarojnë dhe të paguajnë kontribut minimal mujor, në shumën 2 250 (dy mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë.

10. Personat mbi 16 vjeç, me të ardhura të rregullta nga pronësia e që nuk janë të punësuar diku tjetër, duke filluar nga 1.7.2012 e në vazhdim, të paguajnë kontribut vetëm për sigurimin shëndetësor, në masën 7 për qind të pagës mujore minimale, prej 18 295 (tetëmbëdhjetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e pesë) lekësh.

11. Të vetëpunësuarit në bujqësi, nga data 1.7.2012 e në vazhdim, të derdhin kontribut vjetor për sigurimet shoqërore, në masën 27 000 (njëzet e shtatë mijë) lekë, me përjashtim të të vetëpunësuarve, që banojnë në rrethet Bulqizë, Dibër, Gramsh, Has, Kolonjë, Kukës, Librazhd, Malësi e Madhe, Mat, Mirditë, Pukë, Skrapar, Tepelenë dhe Tropojë, për të cilët masa e kontributit
vjetor është 20 400 (njëzet mijë e katërqind) lekë.

…

13. Kontributi i detyrueshëm për sigurimet shoqërore për personat, që punojnë si punëtor shtëpie, nga data 1.7.2012 e në vazhdim, të jetë 2 250 (dy mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë në muaj."

3. Pika 6 e kreut V, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"6.Instituti i Sigurimeve Shoqërore furnizon punëdhënësit dhe të vetëpunësuarit me librezat
e sigurimeve, shoqërore dhe shëndetësore. Punëdhënësi pajis të punësuarit e tij me librezën e kontributeve të sigurimeve, shoqërore e shëndetësore, dhe i plotëson ato çdo muaj në datën e pagesës së pagës mujore. Për të vetëpunësuarit dhe pjesëtarët e familjes të patrajtuar me pagë, si dhe për punëmarrësit e punësuar te i vetëpunësuari, që ka statusin "i vetëpunësuar me punëmarrës", libreza e kontributeve plotësohet dhe vërtetohet nga strukturat lokale, të autorizuara, të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Të vetëpunësuarit në bujqësi, të cilët nk arrijnë të plotësojnë kushtin minimal të vjetërsisë në punë, për të përfituar pension të pjesshëm sipas dispozitave të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, mund të kryejnë pagesa kontributesh edhe pas plotësimit të moshës për pension, por me kusht që ato t'u korrespondojnë periudhave para plotësimit të moshës për pension.

Të vetëpunësuarit në bujqësi paguajnë kontributet për sigurimet, shoqërore dhe shëndetësore, për vitin 2012 e në vazhdim, pavarësisht se mund të jenë të pasiguruar për vitet pararendëse. Periudhat, për të cilat nuk janë paguar kontributet, nuk njihen periudha sigurimi.

Të vetëpunësuarit në bujqësi, të cilët nuk i kanë paguar kontributet e sigurimeve shoqërore për periudhat e kaluara, por që i kanë pasur kushtet për t'u siguruar si të vetëpunësuar në bujqësi, pavarësisht nga vendbanimi aktual, mund t'i paguajnë kontributet me kuotat e vitit përkatës, së bashku me kamatëvonesat e llogaritura.".

4. Pika 9 e kreut V ndryshohet, si më poshtë vijon:

"9. Në tremujorin pasardhës të vetëpunësuarit, pjesëtarët e papaguar të familjes, punëmarrësit e punësuar te i vetëpunësuari, që ka statusin "i vetëpunësuar me punëmarrës", të vetëpunësuarit në veprimtari ambulante dhe të vetëpunësuarit në bujqësi vlerësohen të siguruar, nëse i kanë paguar kontributet e tremujorit pararendës brenda afateve të përcaktuara me ligjin

nr.7703, datë 1.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

5. Kreu VIII ndryshohet, si më poshtë vijon:

“KREU VIII

SHUMA BAZË E PËRFITIMEVE

1. Në mbështetje të neneve 2, 32, 36 e 48 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, shuma bazë e përfitimit nga data 1.7.2012 e në vazhdim, të jetë 11 562 (njëmbëdhjetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë në muaj.

2. Në mbështetje të nenit 96 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, shuma e përfitimit, për personat, që nuk plotësojnë kushtet për përfitimin e masës së pensionit, të përcaktuar në paragrafin e parë të këtij neni, nga data 1.7.2012 e në vazhdim, të jetë 7 841 (shtatë mijë e tetëqnd e dyzet e një) lekë në muaj.

3. Në mbështetje të pikës 3 të nenit 27, të pikës 2 të nenit 59 dhe të nenit 60 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, baza e vlerësuar mujore, për efekt të llogaritjes së të ardhurave për barrëlindje, për rastet kur e drejta e përfitimit ka lindur, por përfituesja nuk ka pagë gjatë gjithë muajve të vitit të fundit kalendarik, llogaritet duke bashkuar shumën e pagave faktike për muajt që është derdhur kontribut për sigurimet shoqërore, me shumën e pagave minimale të përcaktuara, për efekt të derdhjes së kontributtit të sigurimit shoqëror për muajt pa kontribut, pjesëtuar me 12 muaj.

4.Në mbështetje të pikës 4 të nenit 27 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, shuma bazë e përfitimit për gratë, të cilat e kanë periudhën e fundit të sigurimit si të vetëpunësuara në bujqësi, nga data 1.7.2012 e në vazhdim, të jetë 7 841 (shtatë mijë e tetëqind e dyzet e një) lekë në muaj.

5. Në zbatim të pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, si pagë neto për periudhat e punës përpara datës 1.10.1994 vlerësohet të jetë shuma që del pasi, nga paga referuese e përcaktuar me vendimin nr.561, datë 12.8.2005 të Këshillit të Ministrave “Për caktimin e pagës referuese për llogaritjen e pensioneve”, zbritet tatimi mbi të ardhurat personale, i përcaktuar me ligjin nr. 7585, datë 14.7.1992 “Për tatimin mbi të ardhurat personale”, i ndryshuar.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1.7.2012.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Botuar ne F.Zyrtare 78 / 2012
Dale nga shtypi me 09.07.2012